



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 959/prot.
13

Tiranë më 12.9.2017

URDHËR

Nr. 222, datë 12.9.2017

PËR

FSHIRJEN E TË DHËNAVE

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile" dhe organet në varësi të saj "Zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Administrative nr. 4 dhe nr. 9", Tiranë,

K O N S T A T O V A:

Në zbatim të Urdhrit nr. 181, datë 19.07.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile" dhe organet në varësi të saj "Zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Administrative nr. 4 dhe nr. 9" Tiranë, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga ana e personit me initiale A. M në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile" dhe organet në varësi të saj "Zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Administrative nr. 4 dhe nr. 9", Tiranë, vëren se:

Shtetasi _____ nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit pretendon se, me vendimin nr. 1757 datë 26.06.2003 të Gjendjes Civile të Njësisë Administrative nr. 4 Tiranë, ka ndryshuar emrin dhe identitetin e tij, nga _____ në _____ . Nga kjo periudhë e në vazhdim, (për më

shumë së 13 vjet), ankuesi ka nxjerrë dhe përdorur (brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe asaj Greke), dokumenta të rregullta të gjendjes civile me identitetin e tij të ri të ndryshuar nga Njësia Administrative Nr. 4 Tiranë (). Njëpërmjet ankesës z. deklaron se, “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile” në kundërshtim me ligjin ka keq informuar Konsullatën USA në Athinë, për ndryshime dhe përdorime të pavërteta të identitetit tim, në dy raste, të cilët kundërshtojnë në flagrancë njëri tjetrin.

1. Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ të ushtruar konstatoi se ankuesi gjatë kohës që ka qenë banor i Bashkisë Laç rezulton të ketë mbajtur emrin

, Me transferimin e vendbanimit në ish Njësinë Bashkiake Nr. 4, Tiranë, përbërësi i gjendjes civile, rubrika e emrit është pasqyruar “ ”. Në fletën e regjistrit themeltar të Zyrës së Gjendjes Civile të ish Njësisë Bashkiake Nr. 4, që i përket familjes së ankuesit është shënuar se me vendim të zyrës së gjendjes civile nr. 1757, datë 26.06.2003, është ndryshuar emri ankuesit nga “ ” në “ ”.

Familja e ankuesit në datë 13.07.2003 ka ndryshuar vendbanimin nga zyra e gjendjes civile e ish Njësisë Bashkiake Nr. 4, Tiranë, në ish Njësinë Bashkiake Nr. 9, Tiranë. Nga hetimi administrativ i ushtruar u konstatua se përputheshin të dhënat e fletës së regjistrit themeltar të zyrës pritëse me atë dërguese, me përjashtim të rubrikës së emrit i cili është pasqyruar ndryshe nga të dhënat që rezultojnë të pasqyruara në shënimet e vendbanimit të mëparshëm.

Në vendbanimin e mëparshëm (ish Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë), sipas fletës së regjistrit themeltar me vendim nr. 1757, datë 26.06.2003 të Zyrës së Gjendjes Civile, është ndryshuar emri nga “ ” në “ ”. Kjo e dhënë është pasqyruar në mënyrë të ndryshme në fletën e regjistrit themeltar të ish Njësisë Bashkiake Nr. 9, Tiranë. Sipas të dhënave në këtë fletë, e dhëna për emrin rezulton “ ”, e shoqëruar gjithashtu me shënimin e ndryshimit të emrit referuar të njëjtit vendim nr. 1757, datë 26.06.2003, nga “ ” në “ ”.

Informacionin e mësipërm kontrolluesi Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile e ka transmetuar drejt Zyrës së Emigracionit të Konsullatës USA në Tiranë dhe Athinë.

2. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar në Zyrën e Gjendjes Civile të Njësisë Administrative nr. 4, nuk u arrit të administrohej si provë vendimi nr. 1757 datë 26.06.2003 i kësaj njësie. Përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi se kishte kaluar një kohë e gjatë dhe këto vendime kishin kaluar në Arkivën Vendore Shtetërore Tiranë.

Ankuesi z. ka depozituar së bashku me ankesën, shkresën nr. 760/1 prot, datë 06.06.2017, me lëndë kthim përgjigje, të Drejtorisë Rajonale të Arkivit Shtetëror Tiranë njëpërmjet të cilës ky institucion i bën me dije ankuesit se nga kërkimet e kryera në fondin e Bashkisë Tiranë dhe Njësinë Bashkiake nr. 4 dhe 9 viti 2003, nuk u gjetën të dhënat e kërkua lidhur me vendimin nr. 1757, datë 26.06.2003 për ndryshimin e emrit nga “ ” në “ ” apo nga “ ” në “ ”.

3. Nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ të ushtruar rezulton se ankuesi z. [] gjatë kohës që ka qenë banor i ish Njesisë Bashkiake Nr. 4, ka kërkuar të ndryshojë emrin nga [] në []. Ky ndryshim rezulton të jetë pasqyruar saktë në fletën e regjistrit themeltar të ish Njesisë Bashkiake Nr. 9, Tiranë. Ish Njësia Bashkiake Nr. 4 me shkresën nr. 1794/1 të datës 03.07.2003 ka dërguar drejt ish Njesisë 9, fletën e regjistrit themeltar që i përket familjes së ankuesit në të cilën emrin e ankuesit e ka shkruajtur []. Emri [] e ka shoqëruar ankuesin që prej vitit 2003, në cilësinë e subjektit të të dhënave z. [] nuk ka pasur asnjë pretendim rreth këtij fakti pasi ka qenë ai vetë që ka kërkuar ndryshimin e emrit nga “ [] ” në “ [] ”.

Nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Njësinë Administrative nr. 4, rezulton se kanë ndodhur gabime materiale në pasqyrimin e saktë të të dhënave të ankuesit në fletën e regjistrit themeltar të kësaj njësie. Shënimi në këtë fletë për emrin nga “ [] ” në “ [] ” mund të ketë ardhur nga pakujdesia e përpunuesit pasi rezulton se ankuesi nuk ka pasur dijeni dhe nuk e ka kërkuar këtë ndryshim.

Në kushte të tilla, Zyra e Komisionerit vlerëson së mos gjetja e vendimit nr. 1757, datë 26.06.2003 të ish Njesisë Bashkiake Nr. 4 nuk mund të sjellë pasoja për subjektin e të dhënave pasi në zbatim të nenit 27 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, është përgjegjësi e kontrolluesit për të verifikuar nëse masat për sigurinë e të dhënave personale janë përmbushur, siç parashikohet në pikën 1. “*Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e ligjit të sipër cituar.

Në këtë kuadër, është detyrim i kontrolluesit të kryej vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se të dhënat janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar (neni 19) si dhe të informojë marrësin e të dhënave personale për korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, të transmetuara para korrigjimit apo fshirjes.

Neni 30, paragrafi 1, gërma “b” e ligjit të sipërcituar përcakton se: “*Komisioneri ka këto të drejta: b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale*”.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 19, 27, 29, 30/1/b dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile", të kryejë fshirjen dhe korrigjimin e të dhënave personale nga " " në " " në fletën e regjistrit themeltar të Zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë Administrative nr. 4 Tiranë.
2. Kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile", mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 30 ditëve.
3. Në rast mos përmbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më, 12/9/2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

